



PRANUAR MË
ACCEPTED ON: 23/02/2023
PRIMLJENO

Nr.No.Br.

02/28



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -V- (pestë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja u mbajt me datë: 23.08.2024 dhe filloi në ora: 10:40.

Në mbledhje morë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Drejtori për Ekonomi, Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Veton Zogaj, Gentianë Hoti, Sadik Vranezi, Hamit Lima, zyrtar ligjor i Kuvendit Muharrem Morina, përfaqësues nga Drejtori për Arsim Sabit Berisha, përfaqësuesi nga OSBE dhe zyra për informim.

Mungon: Arlindë Rudi (PDK).

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -V- (pestë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent në mbledhje jemi 6 antarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Kush ëtshë për miratimin e rendit të ditës?

Me vota unanime të 6 anëtarëve, Kryesuesi konstatoi se u miratua ky:

Rend i ditës:

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të katërt e mbajtur me datë:21.05.2024, procesverbalit të parë të jashtëzakonshëm i mbajtur me datë: 25.06.2024 dhe procesverbalit të mbledhjes së parë urgjente i mbajtur me datë: 26.07.2024 të Komitetit për Politikë dhe Financa.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve periudhën janar-qeshor 2024.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të auditimit të Komunës së Malishevës për vitin financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2023.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të DKA-së për përfundimin e vitit shkollor 2023-2024 dhe Raporti i shkurtë për fillimin e vitit të ri shkollor 2024-2025.
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme.

Pika e parë

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të katërt e mbajtur me datë:21.05.2024, procesverbalit të parë

të jashtëzakonshëm i mbajtur me datë: 25.06.2024 dhe procesverbalit të mbledhjes së parë urgjente i mbajtur me datë: 26.07.2024 të Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi Argjend Thaçi: A keni diqka rreth procesverbaleve?

Kush është për miratimin e procesverbalit?

Me vota unanime të 6 anëtarëve miratohen procesverbalet

Pika e dytë

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve periudhën janar-qeshor 2024.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Drejtori për Buxhet e Financa Blerim Thaçi: Buxheti i alokuar për këtë periudhë janar-qeshor 2024, kap shumën prej; 14.758.345.49E, çka do të thotë se shkalla e realizimit (alokimit) të buxhetit, në këtë periudhë është 87.14%. Kurse përqindja e tërësishme e buxhetit të shpënzuar në këtë periudhë është 65.13%. Sipas buxhetit për vitin fiskal 2024, nga të hyrat vetanake janë planifikuar të mblidhen, 916.849.00E.

Pra të hyrat e gjithmbarshme, vetanake të realizuara për këtë periudhë kapin shumën prej 920.753.78E. Këtu nuk kanë hyrë gjocat e trafikut dhe gjocat e gjykatave.

Qështja e shujtave dhe të drejtat e përfituesve të mësimdhënësve që janë gjithashtu është në proces dhe realizimi i vendimit të asamblesë për shujtat e zyrtarëve komunal. Kjo po na shkakton telashe për shkak të obligimeve të kontraktuara që i kemi.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Sadik!

Sadik Vrenezi (anëtar nga PDK): Tek tabela 5 është bërë një gabim, këtu ku është 36,000E, kjo shifër duhet të jetë 41.000E. A është gabim teknik?

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima (anëtar nga LDK): Pse po lejoni të shkohet me përmbarues?

Komisionet nuk janë duke u paguar. Ka qenë komisioni i Ekoregjionit për të cilin është marrur vendim për 200E, ka dhe komisione të tjera që janë në këtë gjendje që nuk janë paguar. Ku është problemi?

A po pritni dhe ne me përmbarues me i marr mjetet.

Unë në rend të ditës e prita që të jetë dhe Rregullorja për taksa ngarkesa dhe gjoba. Është dashur të fillojë, nga tash të punohet për atë Rregullore.

Sa i përket raportit këtu po figuron që në fshatin Banjë janë përfunduar rrugë, kanalizime mirëpo në fshatin Banjë nuk është kryer asnjë.

Në këtë raport shënon që janë kryer rrugë dhe në fshatin Dragobil dhe me sa e di unë nuk është kryer asnjë rrugë. Në Dragobil janë shtruar dy rrugë në muajin korrik dhe pse ato rrugë nuk kanë qenë në projekt buxhet.

Në raport kishte asfaltime në fshatin Kërvasari, Ngucat, Llapqevë. Në Kërvasari është duke u

punuar, ndërsa sa i përket fshatrave të tjera nuk e di.

Drejtor, ishin aparatura që janë blerë për shtëpinë e shëndetit, njëra ishte 113,000E, ndërsa tjetra 35,000E. A janë funksionale këto?

Në raport janë dy oborre të shkollave në vlerë prej 9000E, çka keni kryer me këto mjete.

Projektet që kanë qenë më herët deri ku kanë mbërri, sepse ka 3 vite që janë vetëm duke u përsërit. E kam diskutuar dhe më herët rrugën që lidhet Banjë-Lladroc në buxhet është, dhe 50,000.00E kem bërë ridestitim ndërsa pjesa tjetër ku kanë shkuar.

Dhe rregulloren kam dëshirë me vendos në rend dite dhe me trajtuar mirë si për biznese të vogla si për të mëdha.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Vendimet e përmbaruesit vërtetë po na dëmton për vite me radhë dhe nuk po mundemi me dalë kurrsesi prej situatës. 270.000E ishte shuma, që për buxhetin tonë është shumë e madhe dhe ka me shkaktuar problem në investimet tjera kapitale. Është e drejtë e punëtorëve me kërkuar këtë të drejt të tyre që ju garanton ligji apo kontratat kolektive, ndërsa në anën tjetër barrën po e kanë komunat.

Te certifikatat e tjera në vitin 2024 janë 24,494.50E, ndërsa në vitin 2023 janë 27,964.00E.

Gjobat nga Inspektoriati në vitin 2024 janë 105E, ndërsa në vitin 2023 janë 4,252E.

Shfrytëzimi i pronës publike në vitin 2024 janë 9,568,76E, ndërsa në vitin 2023 janë 8,617.88E.

Taksa për certifikata të pronësisë dhe kopje plani dhe këtu janë 1000E më pak.

Gjobat nga trafiku në vitin 2024 janë 13,864.98E, ndërsa në vitin 2023 janë 75,745.06E.

Çka ka ndodhur me tatimin në pronë pse kemi ramje kaq të madhe në inksim të mjeteve.

Tek shpenzimet tek telefonia mobile në 2024 kemi shumëfishim. Shërbime teknike në vitin 2023 ka qenë 2,352.60E, ndërsa në vitin 2024 janë 20,811.00E.

Shpenzime për antarsim në vitin 2023 janë 21,630E, ndërsa në vitin 2024 janë 33,653.86E.

Mobile në vitin 2023 janë 6,566E, ndërsa në vitin 2024 janë 52,946.50E.

Furnizim me dokumente blanko në vitin 2023 janë 1,600.00E, ndërsa në vitin 2024 janë 16,963.00E.

Furnizim me veshmbathje ndoshta kjo është për mjek infermier dhe zjarrfikës zero ka qenë në vitin 2023 ndërsa në vitin 2024 janë 7,943.50E.

Avans për udhëtime zyrtare në vitin 2023 kanë qenë 10,361.00E, ndërsa në vitin 2024 janë 13,468.00E.

Regjistrim dhe sigurim i automjeteve në vitin 2023 kanë qenë 8,759.15E, ndërsa në vitin 2024 janë 16,518.83E.

Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve prapë është dyfishim. Mirëmbajtje e ndërtesave në vitin 2023 kanë qenë 7,410.33E, ndërsa në vitin 2024 janë 128,256.70E.

Mirëmbajtje e monumenteve memorial në vitin 2023 kanë qenë zero, ndërsa në vitin 2024 janë 7,358.72E.

Mirëmbajtja e rrugëve në vitin 2023 kanë qenë 63,274.70E, ndërsa në vitin 2024 kanë qenë zero.

Mirëmbajtje rutinore në vitin 2023 janë 26,541.70 ndërsa në vitin 2024 janë 33.866.00.

Shpenzime për informim, në vitin 2023 kanë qenë 832,00E, ndërsa në vitin 2024 janë 1344.00E.

Kompenzim përfaqësimi në vend, në vitin 2023 ka qenë 12,141.00E ndërsa në vitin 2024 janë 15,220.60E.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Drejtori për Buxhet e Financa Blerim Thaçi: Unë kam qenë shumë i interesuar me i përfundu qështjen e pagesës së Komisioneve. Unë po e lexoj emailin e fundit nga Ahmet Tolaj: Ju njoftojmë se të gjitha organizatat buxhetore përveq pagave të rregullta, seancave që i mbani dhe kujdestaritë si pjesë të pagës nuk mund të procedohen kompenzimet dhe shtesat tjera deri sa të ketë një rregullim të aspektit buxhetor. Është e drejta juaj të shkoni me përmbarues.

Te çështja e rrugëve në teren unë nuk e di se çfarë është punuar sepse nuk është e drejtë e jona me dalë në teren. Ne te rrugët e kemi një kod i cili përfshin më shumë se 8-9 fshatra, ai e cili e sjellë në raportin me punë të përfunduara në një fshat ne e përfundojmë me atë kod ku është përfunduar rruga.

Një pjesë të mjeteve të cilët e cekët për shkolla, ka mundësi që një pjesë dhe në shesh e ka marrë përmbaruesi para 3-4 ditëve 30,000.00E, duhet të deklarohet shpenzimi, duhet ta gjejm në sistem se a është marrë nga përmbaruesi apo është kryer shpenzimi në bazën e realizimit të punëve.

Aparaturat janë blerë në shëndetësi, a funksionojnë apo nuk funksionojnë është drejtorja e shëndetësisë e cila i jep informatat rreth kësaj çështje.

Hamit Lima (anëtarë nga LDK): Klubit të futbollit ja ke ndarë 100.000.00E, MAPL-ja e ka kthyer vendimin dhe me 70,000.00E është shfuziqu vendimi, ndërsa 30.000.00E, ku janë. Si i lëshon 30,000.00E pa pasur asnjë vendim.

Muharrem Morina (Këshilltar ligjor i Kuvendit): Ministria ka thënë që financimi i klubit duhet me u sqaru pronësia e tij dhe mënyra e financimit, nuk e ka kthyer që është i kundërligjshëm.

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet e Financa): Kërkesa duhet të bëhet që të rimbursohen nga Klubi. Veton, gjobat në trafik kanë qenë të vogla ndërsa në tremujorshin e dytë ka rritje. Shpenzimet e telefonisë, kanë qenë disa obligime disa vjeqare që nuk janë kryer dhe është dashur me u kryer një shumë më të madhe për të kryer obligimin që kemi pasur.

Sadik Vrenezi (anëtar nga PDK): Shpeznimet e varrimit janë zero.

Blerim Thaçi Drejtor për Buxhet e Financa): Shpenzimet e varrimit janë zero, nuk është kryer në këtë periudhë, e kemi pasur një telashe deri është nënshkruar kontrata me Bashkësinë Islame. Mirëmbajtja e ndërtesave nënkuptohet që kemi dhe rinovimin e shkollave.

Gentianë Hoti (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Te mirëmbajtja e veturave a mundemi ta kemi si informacion tek shfrytëzimi i veturave. A ka drejtor që i shfrytëzon veturat dhe jashtë orarit të punës, sepse është një shumë e madhe.

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet e Financa): Drejtorja e Administratës është kompetente për këtë.

Gentianë Hoti (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Ka drejtor që i shfrytëzojnë veturat dhe për të shkuar në shtëpitë e tyre dhe ka pasur dhe aksidente me vetura zyrtare. Ajo veturë e aksidentuar është dëmtuar dhe ka hyrë tek mirëmbajtja.

Hamit Lima (anëtar nga LDK): Dhe drejtori i shëndetësisë me veturë zyrtare ka shkuar në Vushtri për ta shikuar lojën.

Muharrem Moriana (Këshilltar ligjor i Kuvendit): Ka rregullore që është miratuar nga Kuvendi e cila ja lejon kryetarit, përveq kryetarit dhe kryesuesit që e ka 24h në shkrytëzim, dhe të dy drejtorët me leje kryetarit e kanë të drejtën jashtë orarit me shfrytëzuar.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Kush është për rekomandim për Kuvend pikën e dytë? Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Pika e tretë

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të auditimit të Komunës së Malishevës për vitin financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2023.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Unë propozoj që këtë pikë me rekomandu për kuvend dhe meqenëse të gjithë drejtorët janë në asamble i kisha dërguar për asamble.

Gentianë Hoti (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Me kërkesë që të gjithë drejtorët të jenë prezent.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Kush është që pika e tretë me u rekomanduar për kuvend së bashku me kërkesën e Gentianës? Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Pika e katërt

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të DKA-së për përfundimin e vitit shkollor 2023-2024 dhe Raporti i shkurtë për fillimin e vitit të ri shkollor 2024-2025.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Prezent e kemi shefin e Drejtorisë së Arsimit, Sabit Berisha. Urdhëro!

Sabit Berisha (përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit): Për shkak të rënies së numrit të nxënësve që e kemi, buxheti që ndahet për kokë nxënësi nga Ministria e Arsimit është i limituar i shkurtuar dhe me këtë buxhet është problem me i dalë të gjithë atyre m katror që i kemi nëpër shkolla. Drejtoria e arsimit me përfundimin e vitit 2023-2024 i ka bërë të gjitha përgaditjet, kemi hapur konkurs të rregullt për plotësimin e kuadrit, ku ka pasur mundësi të bëhet lëvizje të brendshme kemi bërë.

Një problematikë që e kemi pasur gjatë këtij viti shkollorë është furnizimi i nxënësve me tekste shkollore fatkeqësisht kjo po na përsëritet. Ka prindër që atom jete të teksteve shkollore i kanë hargjuar për përfitime të tyre. Gajtë këtij viti i kemi vizituar shkollat me karakter pune dhe nëpër shkollat tona unë mendoj që duhet një angazhim më i madh, i kemi bërë 14 raporte dhe i kemi sygjeruar se si duhet me ndryshuar. Ne si drejtori kemi pasur takim dhe me prindërit e nxënësve, kemi pasur bashkëpunim me Policinë dhe kemi pasur fonde nga Kfori Italian, kemi pajsur disa shkolla me mjete teknologjike.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima (anëtar nga LDK): Kemi pasur rast që me një klas kanë qenë 11 nxënës ndërsa në tjetrën 35 nxënës, A i keni kontrolluar ose a keni marr masa mos po ndodh e njehta gjë prapë. Tani kemi telashe me rrymë, a keni marr masa sepse disa shkolla kanë gjenerator mirëpo i kanë me defekt. A janë pajsur shkollat me topa sepse kanë pasur mungesa.

Renovimi i shkollës së Astrazubit, pse me bërë rinovim sepse 2 vite ka që është lëshuar.
Transporti i nxënësve, a bënë kërkesë ju apo fshati.

Sabit Berisha (përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit): Mbi 3 km ka drejtë komuniteti me bërë kërkesë në drejtorinë e arsimit. Për klasë të parë e drejtë ekspluzive e prindërit është me ja zgjedh mësuesin fëmijës.

Furnizimi me paisje sportive kanë qenë dy herë me nga 10.000,00E për të gjitha shkollat.
Shumica e drejtorëve kanë dhënë mjetet e veta dhe i kanë rregulluar ata gjenerator, nëse kemi probleme prapë duhet me hap një tender që të pajisen shkollat me gjeneratora.

Hamit Lima (anëtar nga LDK): Vitin e kaluar nga DKA, para përfundimit të vitit shkollor që dalin në foto ju kanë shënuar drejtorëve emaila me ofertën e fotograf Xuxit, kjo është si obligim për drejtorin që të merret ky.

Sabit Berisha (përfaqësues nga DKA): Unë do të hulumtojë për këtë.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Sa i përket furnizimit me libra, për ata prindër që mjetet e teksteve shkollore i shfrytëzojnë dhe nuk i blejnë tekstet, është mirë që shkolla, drejtoria me i majtë përgjegjës ata prindër.

Zakonisht po jemi të vonuar me shpalljen e konkursve, tani e pash që është konkursi i hapur me datë 27.

A ka mësimdhënës që i shfrytëzojnë dy ditë të lira brenda 5 ditëshit?

A ka ushtrues detyre të drejtorëve dhe çka ka ndodhur me një konkurs që është shpallur dhe është mbyllur prapë?

Niveli i kalueshmërisë të testit në Gjimnaz që është i ulët. Nëse deri tani e keni favorizuar menaxhmentin aty, është momenti që me marr masa ndaj ati menaxhmenti. E keni pasur si zotim të juajin që keni me vazhduar me vizita sistematike, a keni paraparë plan dhe pse tani ftesa për vaksinim nuk po vjen më nëpër shkolla.

Sabit Berisha (përfaqësues nga DKA): Në bazë të numrit të nxënësve që i kemi na takojnë 500 punëtorë, ndërsa ne sot i kemi 800 mësimdhënës. Sa i përket mungesës së nxënësve kjo donë rregullore specifike të veqant dhe keni me qenë pjesëmarrës dhe ju. Ne kemi shënuar email që mësimdhënësi i cili e ka fondin e orëve 20 orë nuk ka ditë të lirë, i ka 5 ditë pune.

Argjend Thaçi Kryesuesi i Kuvendit): Kush është për rekomandim për Kuvend Raportin e DKA-së për përfundimin e vitit shkollor 2023-2024 dhe Raporti i shkurtë për fillimin e vitit të ri shkollor 2024-2025?

Me vota unanime të 5 anëtarëve, kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kalojmë tek pika e shqyrtimit të kërkesave. Kemi kërkesën 02/363 datë:22.08.2024 për këmbimin e pronës private me pronë publike brenda të njëjtës zonë kadastrale konform dispozitave ligjore.

Muharrem Morina (Këshilltar ligjor i Kuvendit): Këto 33m kërkon me i marr prej pronës publike dhe siç ta vlerëson Ministria e Financave me ia kompenzu. Kërkesa është e plotësuar, pala nuk ka çka ofron tjetër.

Hamit Lima (anëtar nga LDK): Unë mendoj që kjo të shtyhet për një mbledhje tjetër.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Ne kemi disa pika për këmbime të pronave dhe me kryetarin jemi konsultu që me i lënë në mbledhjen e ardhshme, sepse janë kërkesa të natyrës së njëjtë.

Gentianë Hoti (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Nëse është në rregull kërkesa, pse me shty?

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Kërkesa ka ardhur dje dhe kemi kërkesa tjera më të vjetra dhe kemi kërkesa nga kryetari për të njëjtës kategori. Kush është për rekomandim për kuvend kërkesën nr.02/363 datë:22.08.2024?

Për: 5

Kundër: 1

Abstenim: 0

Kërkesa tjetër është nr.02/251, i cili kërkon nga KPF-ja respektivisht nga Kuvendi që të më ndihmojë në botimin e librit “Qështja e dëshmitarëve shqiptarë në Hagë kundër të akuzuarve serbë”. Libri është i përkthyer në tre gjuhë dhe ka materiale të rëndësishme. Këtë kërkesë e rekomandoj te zyra e kryetarit. Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Më herët e kemi pasur dhe një rast të këtillë dhe atëherë kam thënë që nuk jam kundër librave, mirëpo nëse ne e lejojmë këtë duhet me i lejuar dhe të tjerët. Nëse ne e kemi dërguar atë kemi me dërguar dhe këtë.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Kush është për rekomandim për zyre të kryetarit kërkesën nr.02/251?

Për: 4

Kundër: 2

Abstenim: 0

Kërkesa që po i lexoj janë të gjitha me kancer. Kërkesa 02/01, 02/353,02/358,02/161,02/204 Kush është që këto kërkesa të rekomandohen për Kuvend? Me vota unanime këto kërkesa rekomandohen për kuvend. Kërkesa nr.02/78, 02/175, 02/365,02/364,02/178,02/285 po ja ndajmë nga 500E?

Me vota unanime, këtyre kërkesave ndahen nga 500E për secilën kërkesë.

Kërkesa 02/25, në kuadër të vendimit të qeverisë së Kosovës dhe formimin e komisionit për të vendosur emrat e lagjeve, emërtimeve dhe në fshatin Bubavec propozohen emrat përkatës nëpër lagje. Kjo kërkesë të refuzohet për arsye që nuk jemi kompetent për këtë. Kush është për?

Me vota unanime kjo kërkesë refuzohet.

Kërkesa tjetër 02/281, ankesë për lirim të hyrjes në oborr të shtëpisë në lagjen Mirdita tek çerdhja e fëmijëve. Kërkon nga Kuvendi komunal që të më mundësoj hyrjen në shtëpinë time pasi gjatë punimeve më kanë bllokuar hyrjen. Këtë kërkesë po e rekomandojmë për zyre të Urbanizmit. Kush është për rekomandim për Drejtorinë e Urbanizmit?

Me vota unanime kjo kërkesë rekomandohet për Drejtorin e Urbanizmit.


Kërkesa tjetër është 02/334, kësaj kërkesë po i'a ndajm 500E. Kush është për miratimin e kësaj kërkesë? Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahen 500E.

Kërkesat tjetra janë nr.02/146, nr.02/211, nr.02.615, nga 350E po ju ndajmë. Kush është për këto kërkesa?
Me vota unanime, këtyre kërkesave ju ndahen nga 350E. A keni diqka tek pika të ndryshme?
Nëse nuk ka diskutim, këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora:12:10.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

